



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 10/5 Prot.

Tiranë, më 21/2/2013

Lënda: Urdhër për Kontrolluesin "Kupon" Albania, Tiranë.

U R D H E R

Nr 07, datë 21/02/2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr.225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit "Kupon" Albania, Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrit nr.19 datë 14/01/2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar inspektimin administrativ pranë kontrolluesit "Kupon" Albania, Tiranë, me objekt:

- **Ligjshmëria e Mbledhjes, përpunimit dhe e ruajtjes së të dhënave personale të shtetases**, si dhe për subjektet e të dhënave personale që i përkasin kategorisë "Klientë":
- Verifikimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, bazuar në nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Vendimit të Komisionerit nr.2, datë 10.03.2010, për "Përcakimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre", si dhe Udhezimit nr.16, datë 26.12.2011, për "Mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e tyre", në lidhje me:
- Verifikimi i procedurave të realizimit të mesazheve promovionale, të kryera nga kontrolluesi drejt subjekteve të ndryshëm të të dhënave personale;

- Verifikimi i procedurave për marrjen e pëlqimit mbi dërgimin e mesazheve promovionale, të kryera nga kontrolluesi drejt subjekteve ndryshëm të të dhënave personale;
- Verifikimi i masave që ka marrë kontrolluesi lidhur me sigurinë e të dhënave personale, të kategorisë “klientë”, bazuar në nenin 27 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”,

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi “Kupon” Albania, Tiranë ka shkelur nenet 5, 6 dhe 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe Udhëzimin Nr.16, datë 26.12.2011 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë”;

Nga verifikimi i provave shkresore të administruara në dosje, rezultoi se:

- **Shtetases** , në datë 09 Janar 2013, i është dërguar një e-mail promovional, dhe klientes-ankuese nuk i është marrë pëlqimi për mbledhjen e të dhënave personale të saj, përpunimin e tyre, si dhe pëlqimin për sa i përket dërgimit të promovioneve të ndryshme nga kontrolluesi. Gjithashtu, adresa e saj elektronike ishte e shikueshme, e për pasojë dhe e disponueshme nga një numër i madh klientësh të kësaj kompanie promovionesh e-commerce.

Nga kontakti, pranë zyrave të “Kupon” Albania, na u bë e ditur se administratori i kësaj e kompanie e ushtronte aktivitetin e tij jashtë vendit. Për këtë arsye, kontaktet tona kanë qënë më shumë kontakte elektronike.

-Kuponi.al është një faqe interneti pronë e kompanisë Kuponi Albania Sh.p.k, me qendër zyrtare në Tiranë, Shqipëri, e cila operon si zyrë online (e-commerce) dhe nëpërmjet një platforme shit-bletje online i jep mundësinë klientëve të blejnë një shërbim apo një produkt me ulje çmimi. Klientët mund të regjistrohen në të nga faqja e internetit, www.kuponi.al, përmes adresës së tyre e-mail. Sistemi i dërgon një e-mail në këto adresa duke i njoftuar për regjistrimin në databazë me informacionet e nevojshme për ndryshimin apo përjashtimin nga kjo listë; kjo për sa i përket procedurës së mesazheve promovionale.

-Kontrolluesi deklaroi se, çdo e-mail në databazën e tij është regjistruar me pëlqimin e regjistruarit, pra nga vetë ai duke u regjistruar në këtë shërbim nga faqja, www.kuponi.al. Subjekti do të marrë dhe një e-mail njoftimi për regjistrimin në newsletter të KuponiAlbania; kjo për sa i përket, marrjes së pëlqimit, sipas këndvështrimit të kontrolluesit, përfaqësuar nga administratori i tij . Administratori i kontrolluesit, nuk ka të qartë se mekanizmi i “Pëlqimit”, nuk është thjesht një regjistrim vullnetar, por në denifacionin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, neni 3, paragrafi 24, *“Pëlqimi i subjekteve të të dhënave” është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht, me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qënë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat*”; si i tillë, është një procedurë, pa të cilin nuk mund të kuptohet procesi i mbrojtjes së të dhënave.

-Kontrolluesi deklaroi se serverat e kompanisë “Kupon” Albania, Tiranë ndodhen në Hollandë dhe janë të blera nga një kompani hosting me qendër në USA, e cila merret gjithashtu me mirëmbajtjen e serverave në nivel hardëare dhe core-sofware, por të cilët nuk kanë akses të drejtpërdrejtë pa leje në shërbimet e ofruara nga kontrolluesi.

-Gjithashtu kontrolluesi deklaroi se, “Kuponi” Albania nuk ka marrë apo përdorur adresa e-mail të palëve të treta, dhe as nuk vendos apo shton në listën e tij adresa e-mail në mënyrë manuale pa pëlqimin e personit.

-Për sa i përket nivelit të sigurisë, menaxhimi i databazës bëhet nga specialistët IT, të cilët janë të vetmit që kanë akses në databazë me anë të një fjalë-kalimi, dhe aksesit në server bëhet me anë të certifikatave të sigurisë SSL, si masë sigurie.

Në deklaratimet e tij përfaqësuesi i kontrolluesit “Kupon” Albania, Tiranë shprehet se: *“sa i takon kopjes të e-mail që sistemi dërgon, sistemi yne nuk bën ruajtjen e e-maileve të dërguar”*. Ky sistem, i cili nuk ruan e-mailet e nisura nga kontrolluesi me destinacion klientët, pa dashur të gjykojmë, shman në njëfarë mënyre kontrollin e këtyre e-maileve, nga autoritetet legjitime, që kanë kompetenca të ushtrojnë kontrolle mbi subjekte private apo institucione të ndryshme.

-Në faqen e tij në internet, ky kontrollues, ka disa rregulla rreth privatësisë, të cilat janë të pamjaftueshme për mbrojtjen sa më efektive të të dhënave personale të subjekteve-klientë.

Në prani të specialistit IT, të kësaj zyre, u hartua procesverbali, mbi shkeljet e konstatuara nga grupi i punës, të cilat vijojnë si më poshtë:

-Kontrolluesi “Kupon” Albania, Tiranë, në mbledhjen e informacionit të klientëve të vet, sipas deklaratimit që vetë kontrolluesi ka shpallur në faqen e tij në internet disponon informacionin e mëposhtëm:

- Adresë e-maili
- Informacione të kontaktit fizik
- Informacione financiare
- Mesazhet e diskutimeve dhe mesazhe të tjera
- Korrespondencën e ndërsjellë
- Informata lidhur me produktet apo shërbimet që klientët kërkojnë
- Statistika mbi pikëpamjen e faqes

-Në këtë faqe, mungon informimi i plotë i klientit, në lidhje me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të tij personale, nga ana e kontrolluesit.

-Gjithashtu, grupi i inspektimit, vlerëson se të dhënat, si të cilësuar nga kontrolluesi, **“Informacione të kontaktit fizik”**, nuk saktëson klientët se për çfarë të dhënash bëhet fjalë, të ç’natyre janë këto të dhëna.

I-Kontrolluesi, “Kupon” Albania, Tiranë, ka shkelur nenin 5 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, duke nisur mesazhe promovionale në një numër të konsiderueshëm adresash personale elektronike, duke bërë të mundur adresat personale të klientëve dhe nga palë të treta; dhe konkretisht paragrafi 1, gërma “a”, i cili shprehet:

*I.a. “Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:
Në përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme”.*

Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

2- Kontrolluesi, “Kupon” Albania, Tiranë, ka shkelur nenin 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke nisur mesazhe promovionale në një numër të konsiderueshëm adresash personale elektronike, pa marrë paraprakisht pëlqimin e tyre; dhe konkretisht paragrafi 1, gërma “a”, i cili shprehet:

1.a. “Të dhënat personale përpunohen vetëm:

Nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin”.

3- Kontrolluesi, “Kupon” Albania, Tiranë, ka shkelur nenin 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, duke disponuar të dhëna personale të klientit, sipas grupimit të cilësuar prej kontrolluesit “**Informacione të kontaktit fizik**”, ku nuk është e qartë për klientët sasia dhe kategoritw e të dhënave, dhe konkretisht paragrafi 1, gërma “c”, i cili shprehet:

1.c. “Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

Në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

4- Kontrolluesi, “Kupon” Albania, Tiranë, ka shkelur nenin 18 ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”, “Detyrimi për informim”, si dhe Udhëzimit Nr.16, datë 26.12.2011 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë”.

Këto prova shkresore, nuk përputhen me çfarë përfaqësuesi i kontrolluesit, ka pretenduar në rubrikën e parashtrësës së kontrolluesit, në procesverbalin e mbajtur nga grupi i inspektimit për këtë qëllim.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

URDHËROJ

- 1) Në zbatim të nenit 30 pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”:
 - Bllokimi i mbledhjes, rregjistrimit, përpunimit të të gjithë të dhënave personale të klientes , si dhe gjithë klientëve të tjerë me qëllim zhvillimin e marketingut të drejtpërdrejtë të mesazheve promovionale, pa pëlqimin e shprehur të klientëve ekzistuesë dhe atyre të rinj.
 - Fshirjen e të dhënave personale të ankueses-kliente, , si dhe gjithë klientëve të tjerë me qëllim zhvillimin e marketingut të drejtpërdrejtë të mesazheve promovionale, pa pëlqimin e klientëve ekzistuesë dhe atyre të rinj.

- 2) Në zbatim të nenit 6 pika 1 gërma “a” të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të merren masa të menjëhershme për marrjen e pëlqimit të shprehur të klientëve, mbi mbledhjen, regjistrimin dhe përpunimin e të dhënave të tyre personale, si dhe pëlqimin e shprehur, nëse ata dëshirojnë marrjen e promovimeve, nëpërmjet një formulari të veçantë fizik, ose faqes së internetit; kjo mënyrë *onlin-e* të jetë e dokumentuar.
- 3) Në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”, paragrafi 1, gërma “c” të mos mbledhen të dhënat personale apriori, por të saktësohen dhe të shprehen të shkruara të dhënat personale në rubrikën **“Informacione të kontaktit fizik”**.
- 4) Në zbatim të nenit 18, dhe Udhëzimit Nr.16, datë 26.12.2011 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë”, të modifikohet faqja e “Kupon” Albania, Tiranë duke inkorporuar në të, informimin e klientit në mënyrë më të detajuar dhe më profesionale, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.
- 5) Për plotësimin e çdo detyrimi të parashikuar në këtë urdhër, të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- 6) Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të kryhet brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

